

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-111/12**

**Prishtinë,  
17 korrik 2013**

Në çështjen juridike civile

**B. S.**

*Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi*

kundër.

**L. A.**

*Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva - Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtar të Kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/142/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA26069), të datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 17 korrik 2013 morri këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/142/212 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA**

26069), të datës 29 shkurt 2012, dhe hedhet kërkesa për pronën private për shkak të mungesës së juridiksionit.

2. Obligohet ankuesi që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej €60 (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 8 shkurt 2007, B. S. në emër të babait të tij dhe në cilësinë e anëtarit të ngushtë të familjes ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte njohjen pronar dhe posedimin në pronat në Luzhan, Komuna e Podujevës, në vendin e quajtur "Brdo-Voča", ngastrës kadastrale nr. 327, kullosë e klasës të 3-të me sipërfaqe prej 55 ari e 38 m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale nr. 328, kullosë e klasës së 3-të me sipërfaqe prej 23 ari e 39 m<sup>2</sup>, dhe ngastrës kadastrale nr. 329, kullosë e klasës së 3-të me sipërfaqe prej 19 ari e 99 m<sup>2</sup>. Paraqitësi i kërkesës ka theksuar se posedimi i ngastrave është humbur me datë 15 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të vitit 1998/1999 në Kosovë. Kërkesa në AKP është regjistruar me numrin KPA26069.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP këto dokumente:

- Fletën Poseduese nr. 23, e lëshuar me 11 mars 2003 nga Enti Republikan i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë - Shërbimi Kadastral i Komunës së Podujevës. Me këtë fletë poseduese konstatohet se titullar i së drejtës së pronësisë të ngastrave kadastrale që janë objekt i kërkesave është B. S., babai i paraqitësit të kërkesës;
- Aktvendimi i Gjykatës Komonale në Podujevë T.nr.98/03 i datës 23 November 1983, konstaton se babai i paraqitësit të kërkesës B.S. është shpallur trashëgimtar i pronës së paluajtshme të regjistruar në fletën poseduese nr. 23, Zona Kadastrale Lluhan, Komuna e Podujevës;
- Kontrata e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme, e vërtetuar në Gjykatën Komonale në Kurshumli - dega në Podujevë, Vr.nr.287/03 e datës 11 mars 2003, që tregon se është bërë pjesëtimi i pasurisë në mes të D. S., B. S. dhe S.L., në atë mënyrë që B. S. i ka fituar ngastrat kadastrale të sipërpërmendura të kërkuara (nr. 327, 328 dhe 329).

Në vitin 2010, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës, duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej se ndodheshin ngastrat e pretenduara. Pas njoftimit të ngastrave kadastrale që janë objekt kontesti i kërkesës së paraqitur nga paraqitësi i kërkesës, ekipi i njoftimit gjeti se këto paluajtshmëri shfrytëzoheshin nga L. A. nga fshati Sallabajë, Komuna e Podujevës, i cili pretendonte të drejtë pronësore.

Për t'i mbështetur pretendimet e tija, pala përgjegjëse në karkesë ka paraqitur këto dokumente:

- Vërtetimi i Drejtorisë për Ekonomi Planifikim dhe Zhvillim nr. 08/243-07 i datës 19 mars 2007;
- Deklaratën e tij, e cila thekson se ai (pala përgjegjëse në karkesë) ka blerë pronat nga D. S., dhe që janë objekt kontesti i kërkesës së paraqitësit të kërkesës, për shumën prej 30.000 DM, por që ai këto paluajtshmëri nuk ka mundur të transferojë gjyqësisht në emrin e tij, meqë babai i D. S. kishte vdekur, dhe se këto prona ishin të regjistruara në emër të babait të tij dhe jo në emër të tij (D.). Këto prona ai i kishte blerë para konfliktit të armatosur, që domethënë para vitit 1999, dhe se që nga ajo kohë të njëjtën pronë nuk ka mund të kalojë në emrin e tij nëpërmes gjykatës nga se D.S. i ka vdekur babai. Këtë pronë të paluajtshme e ka blerë para konfliktit të armatosur në Kosovë d.m.th. para vitit 1999, dhe se deri atëherë D. S. nuk e kishte penguar kurrë atë t'i shfrytëzonte këto paluajtshmëri;
- Fletën Poseduese nr. 164, lëshuar me 29 nëntor 2011 nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi e Komunës së Podujevës, e cila konstaton se ngastrat kadastrale nr. 327, 328 dhe 329, Zona Kadastrale Lluzhan, Komuna e Podujevës janë regjistruar në emër të B. S., babait të paraqitësit të kërkesës;
- Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-71712048-00164, lëshuar me 7 qershor 2011 nga Zyra Kadastrale e Lluzhanit e Komunës së Podujevës, me të cilën konstatohet se ngastrat kadastrale nr. 327, 328 dhe 329, në vendin e quajtur "Kodra e Voçës", janë prona të B. S., babait të paraqitësit të kërkesës;

Me vendimin e vet KPCC/D/A/142/2012 të datës 29 shkurt 2012, KKPK-ja ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte dhe prova të vlefshme ligjore për të konstatuar të drejtë e pronësisë në pronat që janë objekt kontesti të kërkesës së tij.

Paraqitësi i kërkesës dhe babai i tij janë kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës, dhe ata kanë konfirmuar faktin se bartësi i të drejtës pronësore i pronave të kërkuara i kishte këmbyer ato në vitin 1979 me palën përgjegjëse në karkesë për një ngastër tjetër në një sipërfaqe prej 60 ari. Për më tepër, paraqitësi i kërkesës dhe babai i tij kanë konfirmuar rrethanën se vëllau i bartësit të së drejtës pronësore i ka shitur përsëri palës përgjegjëse në karkesë gjysmën e ngastrës kadastrale me sipërfaqe prej 60 ari, dhe se ata dëshirojnë kthimin e gjysmës së ngastrës së mbetur. Të gjitha

dokumentet e dorëzuara nga ana e paraqitësit të kërkesës janë verifikuar pozitivisht nga ana e Sekretariatit Ekzekutive.

Me 8 gusht 2012, paraqitësit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i KKPK-ës.

Me 2 tetor 2012, pala përgjegjëse në kërkesë ka pranuar vendimin e KKPK-ës, por nuk ka ushtruar ndonjë përgjigje në ankesë.

Pala ankuese duke e kundërshtuar vendimin e KKPK-ës, pretendon se vendimi është përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozim që duke pranuar ankesën e tij vërtetohet e drejta e pronës dhe prona e kërkuar t'i kthehet në posedim. Më tej në ankesën e vet pala ankuese thekson se fillimisht pronat e paluajtshme që janë objekt i kërkesës kanë qenë fillimisht të familjes S. dhe gjyshit të tyre R. S., babait të tij B. S. dhe xhahait të tij babai i tij D. S. Për më tepër, ai thekson se me palën përgjegjëse L. A. asnjëherë nuk ka nënshkruar kurrfarë kontrate të shitblerjes dhe asnjë dokument tjetër lidhur me këmbimin e paluajtshmërive.

#### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale,

Gjykata Supreme konkludon se vendimi ankimor i KKPK-ës është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 paragrafi 2 nëparagrafi (b) i LPK-ës, dhe nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, të cilat shkelje janë të natyrës absolute e për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Prandaj, mbi këtë bazë juridike vendimi ankimor anulohet duke hedhur kërkesën e paraqitësit të kërkesës për shkak të mungesës së juridiksionit të kësaj gjykate dhe rrjedhshmit edhe të KKPK-ës, sipas dispozitës së nenit 198 par 1 të LPK-ës.

Prandaj , vendimi i KKPK-së duhet të anulohet dhe kërkesa të hedhet poshtë (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën, por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Në përputhshmëri me nenet e Nenit 1 dhe Nenit 5 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ 2007/5, paraqitësi i kërkesës – Bojan Stolić ka paraqitur ankesën në emër të babait të tij Boško Stolić.

Me 28 shtator 2010, bartësi i të drejtës pronësore B. S.(babai i paraqitësit të kërkesës) i pronave të cilat janë objekt kërkesë i kërkesës së paraqitur, sikur edhe vet paraqitësi i kërkesës kanë konfirmuar se në vitin 1979 ata kan shkëmbyer me palën përgjegjëse ngastrat e kërkuara me ngastrën në sipërfaqe prej 60 ari. Ata gjithashtu kanë vërtetuar se gjysma e ngastrës në sipërfaqe prej 60 ari, të cilën ata e kishin shfrytëzuar deri në vitin 1999, ishte e uzurpuar nga pala përgjegjëse në kërkesë. Për më tepër, ata kishin theksuar se D. S. – vëllau i bartësit të së drejtës pronësore, i kishte shitur gjysmën e mbetur të ngastrës L. A. por jo të gjithë parcelen. Duke pasur në konsideratë të tërë sipërfaqen e ngastrave, pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë për sa i përket datës së humbjes së posedimit në gjysmën e ngastrës në kohë të ndryshme. Shkëmbimi i pronave midis bartësit të së drejtës pronësore dhe palës përgjegjëse në kërkesë është vërtetuar gjithashtu edhe prej djalit të palës përgjegjëse në kërkesë, i cili shtoi se në ndërkohë ata kishin blerë edhe 60 ari nga D. S., me aprovimin e vëllaut të B. S..

Në vazhdim, paraqitësi i kërkesës/ankuesi sikur edhe bartësi i të drejtës pronësore i ngastrës kadastrale konfirmojnë faktin se ata palës përgjegjëse në kërkesë i kishin shitur gjysmën e ngastrës në sipërfaqe prej 60 ari. Bazuar në dëshmi, mund të konfirmohet padiskutimisht se KKPK-ja, dhe me këtë Kolegji i Apelit të AKP-ës i Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk ka jurisdiksion për të vendosur në këtë kontest juridik, për shkak se faktet e konstatuara dhe dëshmitë e administruara nuk kanë provuar se paraqitësi i kërkesës dhe bartësi i të drejtës pronësore ishin persona të zhvendosur dhe kishin humbur posedimin dhe shfrytëzimin e këtyre paluajtshmërive si rezultat i rrethanave që janë direkt të lidhura ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit të vitit 1999. Posedimi kishte humbu shumë më heret sesa në ngjarjet e vitit 1998/1999 – d.m.th në vitin 1979.

Prandaj, për shkak të arsyeve të sipërcekura dhe mbi bazën e dispozitave ligjore të nenit 3, paragrafi 1 i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të hedhet dhe vendimi i KKPK-ës duhet të anulohet, për shkak së kontesti ligjor nuk bie mbrenda jurisdiksionit të KKPK-ës ose Kolegjit të Apelit të Gjykatë Supreme.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit, për hedhjen padisë maksimumi është 30 euro gjë që përcaktohet në atë shumë, sipas tarifës 10.15 lidhur me tarifën 10.1 sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese e cila ka paraqitur kërkesën e papranueshme. Për më tepër, paraqitësi i kërkesës/pala ankuese ka qenë në dijeni për këtë por pavarësisht kësaj ajo kishte paraqitur kërkesën. Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, kur një person me vendbanim jashtë vendit është i obliguar të paguaj një taksë, afati për pagesën e saj nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe as më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos se afati në këtë rast është 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Udhëzim juridik**

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

*Elka Filcheva - Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Esmat Erterzi, Gjyqtare, EULEX*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Urs Nufer, Referent i EULEX- it*